

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" G.M.A SERVICE" SHPK**

Sot me datën 15.02.2022 (dymijë e njëzet e dy), ne, ortakët themelues :

1. **Mariglen Keçi**, i biri i Besim lindur me 16.04.1984 në Shijak, Durrës, Shqipëri dhe banues në Koxhas, Durrës, shtetas Shqiptar ,mbajtës i kartës së identitetit Nr 027454819.
2. **Aldo Keçi**, i biri i Besim, lindur në 23.05.1990 në Shijak, Durrës, Shqipëtar dhe banues në Koxhas, Durrës, shtetas shqipëtar, mbajtës i dokumentit identifikues pasaportë me Nr BB2972040.
3. **Agron Keçi**, i biri i Besim, lindur në 03.04.1987 në Shijak, Durrës, Shqipëri, dhe banues në Koxhas, Durrës, mbajtës i dokumentit kartë identiteti me Nr 024731609.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit",  
Kemi vendosur të themelojmë *Shoqërinë me Përgjegjësi të Kufizuar "G.M.A SERVICE" SHPK.*

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "G.M.A SERVICE" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në Koxhas, Shijak, Durrës, ndërtesë me nr pasurie 48/36, volume 7, faqe 125, zona kdastale 2255.

**NENI 3**  
**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- Shërbime makinash, kamionash dhe cdo mjeti tjetër motorik, riparime, autoservis.
- Import-eksport të pjesëve të ndryshme të përdorura dhe të reja të makinave, kamionave dhe cdo mjeti tjetër motorik.
- Tregti të pjesëve të ndryshme të përdorura dhe të reja të makinave, kamionave dhe cdo mjeti tjetër motorik në tregun shqipëtar.

**NENI 4**  
**KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË**

Kapitali themeltar i shoqërisë "G.M.A SERVICE" SHPK është 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Ky kapital është i ndarë në 3 kuota, secila me vlerë.  
Kontributi i ortakëve është i ndarë si vijon:

- 1. Mariglen Keçi , zotëron 1 kuotë baraz me 33 % të kapitalit.**
- 2. Aldo Keçi, zotëron 1 kuotë baraz me 33 % të kapitalit.**
- 3. Agron Keçi, zotëron 1 kuotë baraz me 34 % të kapitalit.**

#### **NENI 5**

#### **KOHËZGJATJA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhë kohe të pacaktuar.

#### **NENI 6**

#### **ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. AGRON KEÇI**, e cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqësojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithëkompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

#### **NENI 7**

#### **ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE**

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqëritë Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### **NENI 8**

#### **NDARJA E FITIMEVE**

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar ,të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën , si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

#### **Neni 9**

#### **LIKUJDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

**NENI 10**

**MOSMARRËVESHJET**


Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim. Në rast të kundërt, ortakët do t'i drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

**ORTAKËT THEMELUES TË SHOQËRISË  
"G.M.A SERVICE" SH.P.K**

**MARIGLEN KEÇI**

Mariglen Keçi  


**AGRON KEÇI**

Agron Keçi  


**ALDO KEÇI**

Aldo Keçi  
